



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2327 Prot.

Tiranë, më 29. 12 2025

VENDIM

Nr. 4, datë 29. 12. 2025

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I
MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE (BACHELOR), PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, në Urdhrin e Administratorit të Universitetit të Arteve nr. nr. 133, datë 24.10.2025 “Për fillimin e procedurës së pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, nga ana e fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët do të për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve”, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues, shkresave me listat e studentëve aplikantë të përgatitura nga Kryetaret e Degëve si dhe Sekretaritet Mësimore të secilit fakultet, pas verifikimeve dhe shqyrtimit të diskutimit nga Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës për përfitimin e bursës nga fondi i mbështetjes studentore për studentët aplikues renditur në *Shtojcën nr. 1* bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor pranë Fakultetit të Muzikës, Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).



3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Fakulteti i Artit Skenik të Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha

(Kryetar)

Etjola Kola

(Anëtar)

Oltjon Muzaka

(Anëtar)

Anisa Pollo

(Anëtar)

Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

(Anëtar)

Lorenc Vangjeli

(Anëtar)

Vladimir Llakaj

(Anëtar)

